



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality Kaçanik

01 Nr. 60/01-9631/24
Kaçanik, 29.04.2024

Në bazë të nenit 57.1 dhe 57.2 të Rregullores për Punë të Kuvendit, në çështjen e shqyrtimit të Raportit Vjetor të Komitetit për Komunitete, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 29.04.2024, mori këtë:

VENDIM
PËR APROVIMIN E RAPORTIT TË PUNËS SË KOMITETIT PËR
KOMUNITETE PËR VITIN 2023

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Raporti 01Nr. 60/01-9631/24- më tekstin e mëtejme: “Raport Pune i Komitetit për Komunitete për vitin 2023” i hartuar nga Komiteti për Komunitete.
2. Raporti Vjetor si në pikën 1. të këtij Vendimi, përmban aktivitetin e realizimit të detyrave nga fushë veprimtaritë që janë në kompetencë të Komitetit për Komunitete dhe nivelin e realizimit të tyre për gjatë vitit 2023.
3. Raporti i Komitetit për Komunitete është i përmbledhur në gjithsej 6 faqe dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Komiteti për Komunitete, Kryetari i Komunës dhe Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality Kaçanik

01 Nr. 60/01-9631/24
Kaçanik, 29.04.2024

Na osnovu člana 57.1 i 57.2 Pravilnika o radu Skupštine, po pitanju razmatranja godišnjeg izveštaja Komisije za zajednice, Skupština opštine Kaçanik je na sednici održanoj 29.04.2024. godine primila sledeće:

O D L U K A
ZA USVOJENJE IZVEŠTAJA O RADU KOMISIJA ZA ZAJEDNICA
ZA 2023. GODINU

1. Ovom Odlukom usvaja se Izveštaj 01 br. 60/01-9631/24- sa sledećim tekstom: „Izveštaj o radu Komiteta za zajednice za 2023. godinu“ koji je izradila Komisija za zajednice.
2. Godišnji izveštaj, kao u tački 1. ove odluke, sadrži aktivnost sprovođenja zadataka iz oblasti aktivnosti koje su u nadležnosti Odbora za zajednice i stepen njihovog sprovođenja za 2023. godinu.
3. Izveštaj Komisije za zajednice je sažet na ukupno 6 strana i isti je sastavni deo ove Odluke.
4. Ova Odluka stupa na snagu u skladu sa članom 17. Pravilnika (MAPL) broj 01/2017 – za postupak izrade i objavljivanja akata opštine.

Ovom Odlukom obaveštavaju se: Odbor za zajednice, Predsednik Opštine i Arhiv.

Predsedavajući Skupštine
Kemal Murseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



1	Data	23.06.24	Vendi	KAÇANIK
	Nj. org.		Numri	
		01		00/01-9631/1

RAPORT PUNE
I KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2023

Kaçanik, Prill 2024

RAPORT PUNE I KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2023

HYRJE

Komiteti për Komunitete është trup i përhershëm punues i Kuvendit të Komunës. Komiteti për Komunitete përfshinë në radhët e veta shumicën e thjeshtë nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, anëtarët tjerë janë përfaqesuesit e komuniteteve.

Komiteti i Komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht.

Cdo komunitet që jeton në komunë përfaqesohet nga së paku një përfaqesues në komitetin për komunitete. Përfaqesuesit e komuniteteve joshumicë në komunë e përbëjnë shumicën e anëtareve të komitetit të komuniteteve.

Komiteti ka për detyrë t'i rekomandoj kuvendit të Komunës masat që duhet të ndërmirren për të siguruar jetesimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

DETYRAT DHE PËRBËRJA E KOMITETIT PËR KOMUNITETE

Detyrat e Komitetit për Komunitete janë të përcaktuara në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 05/2020, Statutin e Komunës dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, detyrat e Komitetit për Komunitete janë:

- shqyrtimin e politikave komunale,
- shqyrtimin e praktikave dhe aktiviteteve për të u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht.

Ky komitet i rekomandon kuvendit të komunës masat që duhet të mirren për të siguruar jetesimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën për të u avancuar, shprehur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor si dhe për të siguruar mbrojtjen adekuate të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

Komiteti për komunitete përbëhet nga pesë (5) anëtarë:

- | | | |
|---------------------------------|----------------------------|----------------|
| 1. Lejla Muhaxheri –Çaka | PDK | anëtar |
| 2. Arta Avdiu-Tusha | LVV | anëtar |
| 3. Betim Shala | LDK | anëtar |
| 4. Ekrem Livoreka | AAK | anëtar |
| 5. Arben Thaqi | OJQ Shoqëria civile | anëtar. |

Aktiviteti i Komitetit për Komunitete për gjatë vitit 2023 është zhvilluar në takime të rregullta në bazë të Planit të Punës së Komitetit për Komunitete.

Gjatë periudhës raportuese ky komitet ka mbajtur gjithsej 10 mbledhje të rregullta, ashtu siç janë paraparë në Planin e punës së këtij komiteti, kjo tregon për përmbushje të planit 100%.

Mbledhjet e Komitetit për Komunitete kanë qenë të suksesshme dhe konstruktive, prezenca e anëtarëve në mbledhje ka qenë e rregullt, në mbledhje ka mbretëruar një frymë e punës dhe bashkëpunimit në mes të anëtarëve të përfaqësuar në këtë komitet. Për të gjitha mbledhjet e Komitetit për Komunitete është mbajtur procesverbal nga sektori i kuvendit, i cili është aprovuar në mbledhjen vijuese të Komitetit për Komunitete.

Procesverbali i mbledhjes është bërë transparent në faqen zyrtare të komunës. Për të gjitha mbledhjet, vlen të përmendet se 4 anëtarë të Komitetit për Komunitete janë kompensuar sipas udhëzimit administrativ për kompensimin e stafit politik në komunë, me përjashtim të anëtarit nga OJQ-Shoqëria civile, Arben Thaqi, kundër se është përcjellë raporti i pjesëmarrjes nga sektori i KK, drejtorja për Buxhet dhe Financa, ka shprehur se kanë marrë konfirmimin se nga aspekti ligjor i takon kompensimi, mirepo procedrat për pagesë kanë filluar të bëhen përmes listës së pagave por nuk është aprovuar nga Divizioni i Pagave në Thesarë, sepse pagesa duhet të bëhet përmes SIMFK, kategoria mallra dhe shërbime, andaj ky obligim do të kryet në momentin që do të alokohet buxheti i vitit 2024.

Në mbledhje janë ftuar edhe drejtorët e drejtorive komunale për tema të caktuara për me dhenë sqarime të nevojshme, të cilët disa herë kanë munguar e disa herë të tjera nga pamundësia për të qenë vetë prezent kanë dërguar ndonjë zyrtar nga drejtoria përkatëse.

Gjithashtu në majin e dytë të vitit 2023, grupi ka realizuar dhe një vizitë në objektin e QKMF-ës, ku u pritën nga Drejtori i kësaj qendre z. Sinan Zeneli, dhe u informuan rreth gjendjes aktuale të shëndetësisë në vendin tonë, gjithashtu kanë planifikuar edhe disa vizita tjera për gjatë vitit 2023, por që për arsye të angazhimeve nga ana e institucioneve përkatëse nuk kanë qenë të realizueshme.

ÇËSH TJET E SHQYRTUARA NGA KOMITETI PËR KOMUNITETE

1. Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023

Komiteti për Komunitete ka hartuar një Plan Pune ku janë paraqitur objektivat e Komitetit për Komunitete për vitin 2023, i cili plan pune është miratuar nga Kuvendi i Komunës. Komiteti për Komunitete gjatë periudhës raportuese është munduar t'i përmbush në një formë objektivat e paraqitur si në këtë plan pune, duke trajtuar çështje që janë në interes të qytetarëve, OJQ apo grupeve tjera të interesit, është informuar dhe ka debatuar për çështje të caktuara, por nuk ia ka arritur sa duhet, sepse çdo objektivë e paraqitur si në planin e punës, ka edhe koston financiare, dhe ky komitet nuk është vendimmarrës. Në vazhdim do t'i paraqesim disa nga objektivat e paraqitura në këtë plan, të cilat i ka shqyrtuar Komiteti për Komunitete.

2. Gjendja aktuale e QKMF-ës në komunën e Kaçanikut

Në këtë temë, ka raportuar drejtori i shëndetësisë z. Sali Malsiu, i cili u shpreh se: Gjendja e QKMF-së në komunën e Kaçanikut konkretisht infrastruktura shëndetësore është në nivelin jashtëzakonisht të kënaqshëm, ndërsa një ndër pengesat apo problemet që ai sheh është renovimi dhe mirëmbajtja e objektit si dhe burimet njerëzore dhe kapaciteti i shërbimeve shëndetësore. Ai gjithashtu na informojë lidhur me disa nga statistikat e shërbimeve që kryen brenda javës, muajit dhe vitit në QKMF.

Anëtarët e komitetit për komunitete i shprehën disa nga shqetësimet e tyre tek kjo drejtor, i kryesisht në lidhje me mos vaksinimin e fëmijëve të posalindur, mosrespektimin e orarit të barnatorëve si dhe u kërkua zgjatja e orarit të shërbimeve stomatologjike në vendin tonë. Një shqetësim i grupit ishte dhe neglizhimin që i është bërë muajit të ndërëgjegjësimit të kancerit të gjirit nga kjo drejtori, mungesa e aktiviteteve në këtë muaj delikat si dhe mos sigurimi i aparaturës së mamografisë dhe mos funksionimi i aparatit të rëntgenit në objektin e QKMF-ës. Nga drejtorja u kërkua dhe nevoja e madhe për një gjinekolog/e në vendin tonë, kërkesë e cila u zotua që së shpejti do të realizohet sipas drejtorit Malsiu.

3. Të drejtat e qytetarëve në komunën e Kaçanikut

Në këtë mbledhje pasi që nuk ishin prezent askush lidhur me këtë temë diskutuam vetëm me antarët e komitetit me të cilët ngritem pyetje dhe pakënaqësit që kishim. Disa prej tyre ishin: problematika me HANDIKOS pasi që nuk kanë një trajtim të veçantë dhe nuk kanë ndonjë vend se ku të zhvillojnë aktivitetet e tyre. Tjetra ishte që të organizohen debate publike kur bëhen projektet e mëdha të qytetit tonë si, sheshi i qytetit dhe nënkalmi. Në fund tek të ndryshmet diskutuam rreth çështjes së hartimit, raportit të Planit të Punës së komitetit për Komunitete dhe i kemi ndarë secili antarë nga dy mbledhje në bazë të proceseve verbale.

4. Gjendja e Arsimit në komunën e Kaçanikut

Për gjendjen e Arsimit në komunën e Kaçanikut prezent ishte z. Hajrush Dullovi. Ai tha se në komunën e Kaçanikut janë gjithsej 14 shkolla amë prej të cilave 12 shkolla janë te nivelit fillorë dhe të nivelit të mesëm të lartë, dy shkolla të mesme dhe një qerdhe publike. Ai gjithashtu tregon raportin dhe numrin e nxënësve për vite shkollore ku thot se numri i nxënësve është në rënie të vazhdueshme dhe ishte mjaft shqetësuese. Po ashtu edhe numri i paraleleve dhe numri i të punsuarve ishte zvogluar. Me nivelin e infrastruktures arsimore u shpreh i kënaqur përveq se shkollës së fillores “Emin Duraku” për të cilën tha se është në gjendje jo të mirë infrastrukturore. Anëtarët e Komitetit për Komunitete shprehen disa nga shqetësimet e tyre prej të cilave ishte çështja e pastërtisë në shkolla, mosdizenfektimi i tyre dhe i siperfaqeve . Një shqetsim tjetër ishte siguria në shkolla pasi që ka pasur raste që fëmijet kanë mbajtur armë të ftohta dhe lëndë narkotike.

1.5. Ndarja e granteve dhe subvencioneve për OJQ

Siç dihet grantet ndikojnë në zhvillimin e OJQ-ve, si dhe në cilësinë e aktiviteteve. Sa i përketë aspektit të cilësisë në komunë qendrojmë shumë keq, ndërsa tek masiviteti mund të themi se është përmisuar për shkak se është rritur numri i OJQ-ve dhe si rezultat i kësaj kemi masivitet më të madh të sportistave dhe gara sportive . Zakonisht është thirrja publike që bëhet për OJQ-të dhe ndarjeve të granteve , Shuma e përgjithshme për grantet arrin vlerën afërsisht 66.000.00 euro. Në fushën e rinisë dhe sportit 44.500.00 €, në fushën e kultures 19.500.00 €. Çdo OJQ, duhet me e mbyll atë program , nëse nuk e mbyll atë program dhe nëse nuk arsytohen ato mjete , me automatizem penalizohet për vitin tjetër, si shkas i gjithë kësaj nuk mundesh me përfitu grantin , sepse thjesht nuk e keni mbyllur një projekt , nëse nuk ka aktivitet nuk ka shpenzime .

Klubi i mundjes me të vërtetë na ka bërë krenarë me garat Greqi andaj në vitet e ardhshme duhet me subvencionu më shumë përfshirë edhe të gjitha klubet e tjera që janë aktive.

1.6. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut

Veprat Penale që kanë dominuar gjatë kësaj periudhe janë 161 raste, vjedhje 14, vjedhje të renda 27, vjedhje të renda në tentative 4, vjedhje të shërbimeve 2, demtime në prone 7, kanosje 21, Dhune në familje 8 etj..

Gjendja e sigurisë në shkolla , si dhe e sigurisë së përgjithshme u diskutua nga disa prej antarëve të komunitetit për komunitet , u shpreh shqetsimi i armeve pa leje , kamerave në qytet dhe pjeseve ku kemi levizje me të madhe të qytetarëve .

Ishte shqetsuese për shkak se shumica e kamerave ishin jo funksionale në komunën e Kaçanikut. Sa i përket rasteve të armëmbajtjes janë 11 raste të cilve ju ka konfiskuar arma , dhe janë disa raste në tentativa të cilat janë zbuluar nga vet policia.

Në fund u diskutua për gjendjen e sigurisë të disa fshatrave Ivaj , Strazh dhe Gajre për shkak të vozitësve të kamionave të prerseve ilegale të pyjeve nga vozitja e shpejt.

1.7 Rastet sociale në komunën e Kaçanikut

Komiteti për Komunitete parashih të shtimin e personave që përfitojnë nga skemat sociale, Kaçanikut gjithë e dimë që është komunë me specifika të veçanta dhe me gjendje ekonomike më të varfër në raport me komunat e tjera por edhe nëse e shohim anën tjetër vërehet që inflacioni ka godit Kosovën dhe krejt botën mirëpo kjo vlerë e ndihmës sociale është shumë e vogël që donë të thotë edhe atyre që ja jep nuk ju kryen punë aq sa duhet, çka mund bën një familje me një vlerë 100 euro në jemi shumë i pakënaqur se kemi raste që e refuzojnë por gjendja faktike është gjendje keqe pas refuzimit komisionit mjekësor. Te shërbimi social është një tendencë e rritjes të dhunës në familje.

Shërbimet janë duke u kryer me rregull mirëpo ajo çka na brengos kjo dukuri e rritjes dhunës në familje shqetëson, problemi veç me shkua e me i evidentua rastet edhe me i udhëzua se çka duhet me bë por problemi është pse po ndodhin ato.

1.8 Gjendja e bizneseve në komunën e Kaçanikut

Sipas raportit nga statistikat e regjistrimit të bizneseve. Gjithësej në periudhën nga 1 Janari e deri me datë 25.10.2023 janë regjistruar 143 biznese të reja.

Këto ndahen në SH.P.K. (Shoqeri me përgjegjësi të kufizuar), 87 meshkuj dhe femra 8, ndërsa B.I. (Biznese individuale), meshkuj 32 dhe femra 15.

Dhjetë aktivitetet që shërbehen më së shumti nga bizneset janë ndërtimi i objekteve banesore dhe jo banesore 21 biznese, punime suvatim 18 biznese, mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve 15 biznese.

Bizneset e vogla janë të demtuar nga pandemia dhe konkurrenca jo e drejt nga bizneset e mëdha Viva, Etc etj, duhet një mbështetje nga drejtoria e zhvillimit ekonomik përshkak se këto biznese i udhëheqen nga bizmismena nga komuna Kaçanikut, mbajnë familjet gjenerojnë vende të reja punës.

1.9 OVL e UÇK-së në komunën e Kaçanikut

Vizita me OVL e UÇK-së, u anulua për shkak agjendës së festave nentorit edhe pse ishte konfirmuar nga kryesuesi.

Duke marrë parasysh që shqetësimi i madh në Kosovë është marrja e ushtarëve UÇK-së, nga Gjykata speciale, numri i të ftuarve nga kjo gjykatë në vendin tonë e shohin si shqetësim ket dukuri që po ndodh në kohët e fundit. Sa i përket çështjes së invalidëve të luftës, cilat janë problemet që ata ballafaqohen duke e ditur që në kohët e fundit kanë pasur nevojë për ndihmën e protezave - gjymtyrëve që kanë humbur gjatë luftës ku në, fakt ka pasur mungesë të furnizimit me proteza në vendin tonë. Një ashtu në kohët e fundit janë paraqitur edhe pakënaqësitë lidhur me shumën aktuale të pensionit. Shqetësimi tjetër nga komuniteti për komunitete ka qenë edhe pensioni i veteraneve të punësuar, pse kjo kategori (veteranët të cilët janë të punësuar) nuk e gëzojnë pensionin përshkak se ligji nuk ja lejon.

Ditën e çlirimit me pas aktivitetet të ndryshme me nxensa dhe të njoftohen me luftën - UÇK-së, Kosova deri të pavarsia 2008.

10. Aktivitetet rinore dhe sportive në komunën e Kaçanikut

Shqetësim është suksesi jo i mirë klubeve sportive të cilat edhe pse ,subvencionohen nuk kanë arritur rezultate të mira, përderisa kriteret të cilat edhe i kemi përmend shpeshherë si suksesi dhe masiviteti nuk janë trajtuar si kritere në ndarjen e mjeteve buxhetore për aktivitet e lartpërmendura, andaj mendojmë i njëjti avaz do të vazhdojë deri sa nuk do të ket kriteret për ndarjen e subvencioneve edhe viteve në vazhdim.Drejtori të ndërmarrë masa që këto organizata ndonjëherë edhe jo të përgjegjshme të sanksionohen për shkak të rezultateve jo të mir klubeve sportive duke bërë ndonjë hulumtim, se ku ngecim (qalojnë) , arsyeja se pse nuk po arrijnë rezultate.

Për aktivitet rinore sidomos në fushën e kulturës, kur bëhet fjalë për një date historike, të ketë audiencë më të madhe njerëzve, masivitet më të madh pasi që është shqetësueses numri i pjesëmarrëseve në ato aktivitete.

Komuniteti për kominitet shpreh shqetsimin për mos pjesmarrje të disa drejtoresh dhe zyrtareve në mbledhjet e komunitet që është në interes të komunitetit por shpresojm se në të ardhmen do të kemi pjesmarrje në diskutim për zgjedhje të problemeve të komunitetit.

Komiteti për Komunitete veprimtarinë e vet do të zhvillojë në bazë të Planin e punës për vitin 2023, ku i ka paraqitur aktivitetet në mbledhje të rregullta dhe aktivitete tjera, i cili plan punë është aprovuar nga Kuvendi i Komunës me 31.01.2023.

Për Komitetin për Komunitete

Kryesuesi, Ekrem Livoreka

